



THIRRJE PUBLIKE PËR SKEMËN E GRANTEVE

Një mjet për nxitjen e arsimit dual në Kosovë

Udhëzimi për aplikim: Thirrje publike për mbështetje financiare për ta promovuar arsimin dual nëpërmjet bashkëpunimit në mes të bizneseve dhe institucioneve publike të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP).

Autoriteti kontraktues dhe zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).

1. Sfondi

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, LuxDev, Agjencinë e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), po e lansojnë skemën e granteve për arsimin dual.

Kjo skemë e granteve synon ta promovojë arsimin dhe aftësimin profesional dual, duke i inkurajuar kompanitë e sektorit privat (punëdhënësit) që të ofrojnë zgjidhje kreative për të bashkëpunuar ngushtë me institucionet publike të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), si dhe me ofrues të akredituar të trajnimeve.¹

Skema financohet nga Dukati i Madh i Luksemburgut përmes projektit të LuxDev "Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë".

2. Qëllimi dhe rezultatet e pritshme (Qëllimi)

Qëllimi i skemës së granteve është krijimi i partneriteteve ndërmjet sektorit privat (bizneseve) dhe IAAP-ve publike që do t'u mundësojnë nxënësve të fitojnë përvojë praktike të punës sipas modelit të arsimit dual, me fokus të veçantë që t'u ofrojnë grave mundësi trajnimi dhe punësimi.

¹ Ofruesit e trajnimeve të kontraktuar përmes konsorciumit duhet të jenë të akredituar ose në proces akreditimi nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Kurset jo-formale ose afatshkurtra që ofrohen nga këta ofrues trajnimi nuk kanë nevojë të jenë të akredituara, edhe pse akreditimi inkurajohet shumë.

Kjo skemë inovative e granteve organizohet në dy dritare financimi për ta dalluar më mirë përkrahjen e arsimit formal nëpërmjet profileve të arsimit dual dhe arsimit joformal nëpërmjet kurseve afatshkurtra, duke përdorur metodologjinë e arsimit dual sa herë që është e mundur. Aplikimet mund të bëhen për:

1. **Dritarja 1 (e detyrueshme):** Mbështetje për kompanitë private (punëdhënësit), me prioritet për ato që operojnë në sektorët e Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtëritshme, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Përpunimit të Drurit dhe Përpunimit të Ushqimit, nëpërmjet një kontrate partneriteti trevjeçare me një IAAP publik që zbaton profile të arsimit dual.
2. **Dritarja 2 (opsionale):** Mbështetje për kompanitë private që të kontraktojnë ofrues të akredituar të trajnimeve (duke përfshirë edhe qendrat trajnuese brenda kompanive) për të ofruar arsim joformal afatshkurtër (kurse afatshkurtra), nëpërmjet dorëzimit të një plani trajnimi me ofrues të mundshëm trajnimi, për ta promovuar metodologjinë e arsimit dual, rikualifikimin dhe ngritjen e shkathtësive.

Rezultatet e pritshme janë si në vijim: Shkollat e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP) do të krijojnë partneritete me bizneset lokale përmes marrëveshjeve trevjeçare, dhe granti do t'u ofrojë këtyre partneriteteve burime për ofrimin e trajnimeve cilësore. Si rezultat, kompanitë do të kenë qasje në punëtorë të kualifikuar që i përgjigjen nevojave reale të tregut.

3. Aplikuesit e pranueshëm

Aplikuesit e pranueshëm për këtë skemë të granteve janë bizneset vendore, përfaqësues të sektorit privat që mund ta promovojnë arsimin dual. Prioritet i projektit janë sektorët: Energjia e Ripërtëritshme dhe Eficienca e Energjisë (ER/EE), Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Prodhimi (përfshirë përpunimin e drurit dhe përpunimin e ushqimit). Edhe pse projekti është i fokusuar në këto fusha, edhe sektorët tjerë me potencial për promovimin e arsimit dual mund të merren në konsideratë.

Kusht themelor për aplikim për skemën e granteve është krijimi i konsorciumit- marrëveshjes ndërmjet bizneseve lokale dhe shkollave publike të AAP-së, me sektorin privat në rolin udhëheqës të aktiviteteve. Kjo duhet të përfshijë garanci financiare për ndarjen e kostos brenda periudhës trevjeçare të kontratës, si dhe garancinë nga biznesi lokal për zbatimin e projektit dhe vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet biznesit lokal dhe IAAP-së publike edhe pas përfundimit të projektit.

4. Mbështetja financiare që ofrohet nga KIESA/LuxDev

Totali i skemës së grantit është 1,000,000 euro, me Dritaren 1, që ka për qëllim mbështetjen e të paktën 10 konsorciumeve ndërmjet bizneseve private dhe shkollave publike të AAP-së për promovimin e arsimit dual. Dritarja 2, e skemës së granteve synon t'i mbështes ofruesit e akredituar të trajnimeve për t'i ofruar konsorciumit kurse afatshkurtra, bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnime të realizuar paraprakisht nga konsorciumi. Përfituesit kryesor synohet të jenë nga shtatë rajonet e vendit dhe çdo propozim fitues duhet t'i përfshijë të paktën 10 nxënës brenda periudhës së kontratës tre vjeçare.

Shuma e aplikimit për projekt duhet të jetë nga 50,000 EUR deri në 100,000 EUR.

KIESA/LuxDev do të kontribuojnë me 80% deri në 90% të kostos totale të projektit, ndërsa konsorciumi do ta mbulojë pjesën tjetër të projektit.

Administrimi i skemës së granteve do të bëhet nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, ndërsa LuxDev do ta ketë përgjegjësinë e menaxhimit të pjesës financiare të skemës së granteve.

5. Dokumentet që kërkohen sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset që e kanë numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal në një certifikatë).
3. Vërtetimi tatimor me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të papaguara apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxhit.
4. Kopjen e lejes së njoftimit të personit(ve) në emrin e të cilit është regjistruar aplikuesi.
5. Dëshminë nga aplikuesi se nuk është në falimentim apo nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - origjinali, ky dokument mund të nxirret në Gjykatën Komerciale, jo më e vjetër se 30 ditë.
6. Dëshminë e llogarisë bankare aktive të aplikuesit në njërën nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
7. Gjendjen e llogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit (2025). Kjo nuk do të aplikohet për aplikuesit e sapo themeluar.
8. Projekt-propozimi duke përfshirë se paku qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare dhe planin kohor të realizimit të projektit, si dhe strukturën organizative të aplikuesit, të dhënat e të cilit janë të paraqitura në aplikacion.
9. Për ndërmarrjet e regjistruara para vitit 2024, duhet të sjellin qarkullimin për vitin 2024 dhe 2025 i dëshmuar me dokument të lëshuar nga ATK. Për ndërmarrjet e regjistruara gjatë viteve 2024 dhe 2025 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi. Ndërsa, për ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2026 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi.
10. Të mos këtë pranuar mjete nga burime të tjera financimi për të njëjtat aktivitete (kjo dëshmohet me deklaratën nën betim), e cila mund të shkarkohet në *ueb faqen* zyrtare të KIESA's të plotësohet dhe të ngarkohet për aplikim.
11. Aplikuesi i ka përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga mbështetja e mëhershme financiare, nëse kanë përfituar nga burimet e financimit publik dhe/ose nga ish-emërtimet (MTI/MINT) MINTI në dy vitet e fundit (kjo dëshmohet me deklaratën nën betim), e cila mund të shkarkohet në *ueb faqen* zyrtare të KIESA's të plotësohet dhe të ngarkohet për aplikim.

Dokumente shtesë që kërkohen

Dokumentet e mëposhtme duhet të dorëzohen nga konsorciumi në kohën e aplikimit:

- Certifikata e akreditimit të lëshuar nga AKK, valide në kohën e aplikimit (nuk vlen për IAAP-të publike të menaxhuara nga komunat dhe Qendrat e Kompetencës – QK të

menaxhuara nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARr)). Nëse ofruesi i trajnimeve është në proces të ri-akreditimit, mjafton kërkesa për ri-akreditim e vulosur nga AKK që konfirmon pranimin e kërkesës.

- Marrëveshja e nënshkruar e partneritetit ndërmjet anëtarëve të konsorciumit që përfshin:
 - Rolet e secilit partner të konsorciumit,
 - Përgjegjësitë e secilit partner të konsorciumit,
 - Menaxhimin financiar,
 - Komunikimin,
 - Monitorimin,
 - dhe çdo angazhim tjetër të dakorduar ndërmjet partnerëve të konsorciumit.

Kërkesat për dorëzimin e propozimeve dhe sqarimet

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- Të gjithë nxënësit që përfitojnë nga një profil i arsimit dual që mbështetet nga projekti duhet ta kenë një pozitë të siguruar në një kompani private për komponentin e trajnimit në kompani.
- Të gjithë nxënësve duhet t'u ofrohet një kompensim (100% i mbuluar nga kompanitë private në kuadër të buxhetit të bashkëfinancimit sipas rregullave të Ministrisë së Arsimit) dhe kostot e sigurimit që ofrohen nga kompanitë private, respektivisht komunat. Në rast të marrëveshjes së ndërsjellë, sektori privat mund t'i mbulojë edhe kostot e sigurimit, me kusht që të përmendet në buxhetin e bashkë-financimit.
- Pajisjet që kërkohen të subvencionohen duhet të jenë të reja dhe të kenë dëshmi për markën e Konformitetit Evropian (CE).
- Përfituesi nuk ka të drejtë të shesë asnjë pajisje të blerë përmes këtij granti brenda tre viteve nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit. Kjo klauzolë do të jetë pjesë përbërëse e marrëveshjes së grantit.
- Në rast të ndonjë kostoje të paparashikuar në lidhje me implementimin e projekt propozimit, përfituesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e këtyre shpenzimeve, nëse implementimi i projektit behet me kosto me të ulet atëherë kompania përfituese obligohet ti kthejë diferencën e mjeteve sipas përqindjes së grantit
- Në rast të përfitimit nga granti, nuk lejohet ndryshimi i idesë fillestare bazë siç përshkruhet në projekt propozim gjatë fazës së implementimit të projektit.
- Çdo aktivitet tjetër që nuk është në përputhje me këtë thirrje publike nuk do të pranohet.
- Aplikuesi duhet ta paraqesë pjesëmarrjen e financimit të tij (minimum 10% e buxhetit) në pjesën e buxhetit të aplikacionit.
- Para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, përfituesi është i obliguar që ta hapë një llogari të re bankare ose nën llogari të dedikuar për ta administruar grantin.
- Para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, kompania udhëheqëse që aplikon obligohet që ta sjellë garancionin valid bankar të lëshuar nga një institucion financiar të regjistruar, të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), për vlerën totale të grantit deri në përfundim të projektit

- Pasi që kjo skeme ka për qëllim të promovojë dhe zhvillojë arsimin dual dhe është financim i drejtpërdrejtë nga Qeveria e Luksemburgut, atëherë të drejte aplikimi kanë të gjitha ndërmarrjet pavarësisht nga skemat tjera të KIESA's.
- Ndërmarrjet të cilave iu ka skaduar afati i marrëveshjeve nga skemat paraprake të KIESA's dhe që nuk i kanë përmbushur obligimet e atyre skemave, nuk kanë të drejtë përfitimi nga kjo skemë.
- Nëse kompania është përfituese, atëherë do të nënshkruhet një marrëveshje, pjesë e të cilës do të jenë edhe deklaratat e bëra gjatë aplikimit.
- TVSH-ja është një shpenzim i pranueshëm për personat fizikë dhe ndërmarrjet që nuk e deklarojnë TVSH-në, ndërsa për ndërmarrjet që e deklarojnë TVSH-në, ky është një shpenzim i papranueshëm.
- Lista e ndërmarrjeve të vlerësuara do të publikohet në ueb-faqen e MINTI/KIESA. Varësisht nga limitet buxhetore, lista e bizneseve përfituese mund të parasheh deri në 5 biznese rezervë. Në rast të tërheqjes apo dështimit të ndonjë biznesi përfitues, atëherë ai mund të zëvendësohet me bizneset rezervë.
- Skema e granteve synon t'i mbështes drejtpërdrejt bizneset dhe e inkurajon ngritjen e kapaciteteve profesionale përbrenda kompanive. Prandaj, kompanitë konsulentë që ofrojnë shërbime për bizneset aplikuese përjashtohen nga ky proces me këtë thirrje. Në rast të identifikimit të përfshirjes së tyre si përfaqësues të bizneseve, aplikuesit do të diskualifikohen. Kjo për shkak se i tërë procesi është i thjeshtë dhe pa kosto financiare, duke filluar nga metoda e aplikimit elektronik përmes emailit zyrtar, deri te vlerësimi, nënshkrimi i marrëveshjeve, shpërndarja e fondeve dhe monitorimi i tyre.
- Bizneset kanë të drejtë të aplikojnë vetëm një herë, duke përdorur një adresë të vetme emaili. Çdo biznes që dërgon më shumë se një aplikim me email të njëjtë apo të ndryshëm do të diskualifikohet.

Shënim i rëndësishëm:

Në rast të mos-përmbushjes së kriterëve, formulari i aplikimit do të konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

6. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e projektit të financuar nga Qeveria e Luksemburgut nuk mund t'i kalojë 12 muaj.

7. Si të aplikoni

- Thirrja publike shpallet në ueb-faqet zyrtare të MINT dhe KIESA:
 - <https://mint.rks-gov.net/>
 - <http://kiesa.rks-gov.net/>
- Aplikimi bëhet vetëm online përmes emailit: arsimidual@rks-gov.net. Forma të tjera të aplikimit nuk pranohen.
- Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve shoqëruese është deri më datë 30.04.2026 në 23:59h
- Informata shtesë mund të kërkohen përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

8. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit për aplikacionet e Dritares 1

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Kriteret A - Përshtatja strategjike me ofertën e propozuar të trajnimit	20
A.1 Përshtatja e investimeve me planifikimin e ofertës së trajnimit	15
A.2. Zhvillimi i sektorëve që konsiderohen si prioritet	5
Kriteret B - Përshtatshmëria e kompetencave të qendrës dhe kapaciteti i brendshëm për zbatim	15
B.1. Kapaciteti i brendshëm për zbatim	10
B.2. Kapaciteti teknik i instaluar	5
Kriteret C - Përgjegjësia ndaj nevojave të sektorit privat	25
C.1. Kontributi i propozimit në zhvillimin e sektorit privat dhe profileve të arsimit dual që konsiderohen strategjike për zhvillimin socio-ekonomik të vendit	25
Kriteret D – Cilësia e projektit	30
D.1. Inovacioni – Trajnimi pedagogjik dhe metodologjik	10
D.2. Inovacioni teknologjik	10
D.3. Modernizimi i hapësirave të trajnimit	10
Kriteret E – Grupet prioritare	10
E.1. Grupet prioritare	10
TOTALI i pikëve maksimale	100

Kriteret shtesë të vlerësimit për Dritaren 2

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Kriteret A – Përputhshmëria strategjike	25
A.1. Zhvillimi i sektorëve të konsideruar strategjikë	10

A.2. Zhvillimi i kompetencave përmes shkathtësive transversale	15
Kriteret B – Cilësia e trajnimeve të propozuara	35
B.1. Inovacioni	15
B. 2. Kontributi i propozimit në zhvillimin e sektorit privat	20
Kriteret C – Potenciali i punësueshmërisë	40
C.1. Punësueshmëria	40
TOTALI i pikëve maksimale	100

Shënim: Për aplikantët, në rast se përfitojnë, deklaratat në projekt-propozim do të pasqyrohen në marrëveshjen ndërmjet palëve. Nëse gjatë procesit konstatohet se janë paraqitur informacione ose të dhëna të rreme ose të pasakta, biznesi do të diskualifikohet dhe çështja do të procedohet më tej sipas ligjeve në fuqi.

9. Ankesat

Pas shpalljes së rezultateve preliminare, aplikantët mund t'i dorëzojnë ankesat e tyre brenda afatit të përcaktuar në UA 01/2018, vetëm përmes emailit: arsimidual@rks-gov.net

Shënim: Nëse informacioni i ofruara në këtë aplikacion vërtetohet të jetë i pasaktë, biznesi nuk do të paguhet dhe do të mbahet përgjegjës për të gjitha pasojat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.